



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:129152

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05733746

CN.nr.47/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani, në çështjen juridike të propozueses M Zh - S nga M, tani me vendbanim në Apartme, rr. H A, T– K, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Av. Syqyri Sylja, duke vepruar sipas propozimit për pranimin - njohjen e vendimit të Gjykatës së shtetit të huaj, në përputhje me nenin 168 të Ligjit nr.08/L-028 për të Drejtën Ndërkombëtare Private të Republikës së Kosovës, jashtë seancës me datë 24.05.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET Aktgjykimi i formës së prerë për zgjidhjen e martesës pa ndonjë pronë ose fëmijë vartës ose të mitur i Gjykatës Supreme te Drejtësisë – T– K, me numër të lëndës i datës ..., me të cilin është zgjidhur martesa me shkurorëzim, ndërmjet tani propozueses M. Zh. – S. e lindur me datën ..., ne M. tani me vendbanim në Apartment ..., rr. H. A., T., O. ... – K. dhe kundër propozuesit B. S. i lindur me dt...., ne M. me vendbanim në .. F. P., T., ...,

A r s y e t i m

Propozuesja M. Zh. – S, me datën ... ka paraqitur propozim për njohje të vendimit të huaj përkatësisht për pranim - njohje të Aktgjykimit të formës së prerë për zgjidhjen e martesës pa ndonjë pronë ose fëmijë vartës ose të mitur i Gjykatës Supreme te Drejtësisë – T. ne K., me numër të lëndës ..., i datës ..., me të cilin është zgjidhur martesa me shkurorëzim, ndërmjet tani propozueses M.Zh. – S. dhe kundër propozuesit B. S.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës konstaton se propozuesja, së bashku me propozimin për njohje të vendimit të huaj, si provë i ka bashkëngjitur Aktgjykimin e formës së prerë për zgjidhjen e martesës pa ndonjë pronë ose fëmijë vartës ose të mitur i Gjykatës Supreme te Drejtësisë – T. ne K, me numër të lëndës ..., i datës ,, përthimin e tij në gjuhën shqipe, dhe certifikatën e martesës me numër reference ,, e lëshuar me dt, ...

Gjykata konstaton se vendimi i lartë cekur, përbën dokument zyrtar të shtetit të huaj, dhe se janë plotësuar kushtet ligjore për njohje të vendimit të huaj të përcaktuar në nenin 160 deri 165 të Ligjit numër 08/L-028 për të Drejtën Ndërkombëtare Private të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me nr. 30 të datës 05.09.2022 në Prishtinë si dhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 12 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat të Republikës së

Kosovës e cila dispozitë përcakton se: “2. Gjykatat themelore janë kompetente për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja.”, konstaton se janë plotësuar kushtet për pranimin e këtij vendimi dhe në përputhje me nenin 170 paragrafi 1 të Ligjit nr.08/L-028 për të Drejtën Ndërkombëtare Private të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
CN.nr.47/24, datë 24.05.2024

Gjyqtari,
Genc HASANI

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim është i formës së prerë meqë propozuesi ka hequr dorë nga e drejta në ankesë.